


KONKURSI I PRANIMIT
NË
FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE
URBANISTIKËS

Vitin akademik 2023 2024


Kodi i Sekretimit:

1) Në figurë paraqitet një elips. Ai është ndërtuar duke përdorur:





- A) Diagonalen ?
- B) Boshtin me të madh ?
- C) Boshtin me të vogël ?
- D) Dy boshtet ?

2) Cila nga planet, korespondon me pamjen perspektive?



- A)
- B)




3) Në cilin vit u vra John F. Kennedy?

- A) 1967 B) 1965 C) 1961 D) 1963

4) Si emërtohej, në të shkuarën, tregu i mbyllur që shërbente për shitjen e mallrave të çmuara?


- A) Natar B) Pitar C) Bezisteni D) Patan

5) Referuar përmasimit të dollapit në cm, sa është sipërfaqja në m² e dhomës së paraqitur në plan.?



- A) 12.0 m² B) 13.2 m² C) 12.6 m² D) 13.8 m²

6) Në figurë paraqitet plani i dhënë me dy vijëdrejta paralele. Si është ky plan?



- A) Pingul me planin H ?
- B) Paralel me planin H ?
- C) Paralel me planin V ?
- D) Pingul me vijen e tokës ?

7) Një dysheme kuadratike ka brinjën 13 metra. Investitori kërkon ta veshë me pllaka kuadratike të bardha e të zeza prej 1 metër secila. Projekti është me të gjitha pllakat e bardha përvec atyre rreth e qark kornizës si dhe krijimi i një kryqi në mes që duhet të jenë me pllaka të zeza. Sa pllaka të zeza duhet të porosisi arkitekti?

- A) 65 B) 78 C) 69 D) 70


8) Kalaja e Lëkurësit gjendet në afërsi të:

- A) Gjirokastrës B) Përmetit C) Sarandës D) Tepelenës

9) Për ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë u shemb:

- A) Teatri B) Kisha ortodokse C) Bashkia D) Pazari i vjetër

10) Në figurë paraqitet pamja ballore e trupit.



Cila nga alternativat e dhëna, korespondojnë me të?




1

A) Figura 4




2

B) Figura 3




3

C) Figura 2 dhe



4

D) Figura 1



5

11) Cili nga vendet e mëposhtëm NUK ka qenë pjesë e themeluesve të Traktatit të Varshavës në 14 maj 1955?

A) Republika Popullore e Shqipërisë

B) Republika Popullore e Hungarisë

C) Republika Popullore Federale e Jugosllavisë

D) Republika Demokratike e Gjermanisë

12) E drejta e grave për të votuar në Shqipëri daton në vitin:

A) 1945

B) 1912

C) 1920

D) 1961

13) Katër kuadrat e vizatimit, kanë të njëjtat brinjë. Me të zezë është ngjyrosur një sipërfaqe si në figurat përkatëse. Cili pohim është i saktë?



Figura 1



Figura 2



Figura 3



Figura 4

A) Figura 3 ka sipërfaqen e zezë më të vogël se të tjerat.

B) Figura 2 dhe 4 kanë sipërfaqet e zeza më të mëdha se sa figura 1 dhe 3.

C) Figura 1 ka sipërfaqen e zezë më të vogël se figurat e tjera.

D) Të katërta figurat kanë sipërfaqen e zezë të barabartë.





14) Stadiumi më i hershëm i zbuluar në Shqipëri i përket shekullit III p.e.s. dhe ka pasur një kapacitet prej 4000 spektatorësh. Ky stadium ka qenë pjesë e qytetit ilir të:

- A) Antipatresë B) Bylisit C) Amantias D) Dimalit

15) Traktati i Versajës, i cili ishte Traktati i Paqes në përfundim të Luftës së Parë Botërore, u firmos më:

- A) 15 Prill 1917 B) 28 Qershor 1919 C) 23 Korrik 1914 D) 11 Nëntor 1918

16) Në figurë paraqiten trupat në të njëjtën tip aksonometrie. Përvec përmasave të dhëna, cfare karakteristike tjetër kanë të përbashkët?





A) Pamjen në ballor dhe anësor ?

B) Pamjen në anësor ?


C) Pamjen në ballor ?

D) Pamjen në anësor dhe horizontal ?


17) Cila nga alternativat është paraqitja e projeksioneve të vijëdrejtës së dhënë në aksonometri ?




A)



B)



C)




D)

18) Kur u shemb muri i Berlinit?


- A) 9 tetor 1990 B) 9 nëntor 1989 C) 9 shtator 1990 D) 9 dhjetor 1989

19) Në figurë paraqitet ndërtimi i spirales e cila është:




- A) Me tre qendra ?
- B) Me dy qendra ?
- C) Me një qendër ?
- D) Me katër qendra?

20) Duke ditur që lartësia e një këmb shkalle që është 18 cm, cila nga shkallët e dhëna nuk mund të na shërbejë për tu ngjitur në kuotën 3.24m?



A)

B)



C)

D)

21) Mari Kyri [Maria Salomea Skłodowska-Curie] ishte një shkencëtare e njohur për studimet mbi:

- A) Optikën
- B) Radioaktivitetin
- C) Elektromagnetizmin
- D) Termodinamikën

22) Cili nga piktorët e mëposhtëm është i njohur për veprën e tij surrealiste ku paraqiten orë të shkrira?

- A) Joan Miró B) René Magritte C) Salvador Dalí D) De Chirico

23) Cili nga planetët e mëposhtëm nuk ka satelitë?

- A) Afërdita B) Marsi C) Urani D) Neptuni


24) Cili kuvend zhvillohet në 2 mars 1444, me synim krijimin e Lidhjes së Princave shqiptarë?

- A) Kuvendi i Shkodrës B) Kuvendi i Dibrës
C) Kuvendi i Lezhës D) Kuvendi i Krujës

25) Aria "Nessun dorma" është pjesë e aktit final të cilës opera?

- A) Carmen B) Rigoletto C) Turandot D) La Traviata

26) Imazhi i mëposhtëm paraqet projektin e një kopshti. Gjeni sa % e kopshtit është e mbjellë me trëndafila të verdhë, në krahasim me llojet e tjera të trëndafilave?



- A) 30 % B) 16 % C) 20 % D) 25 %

27) Kërkohet të vazhdohet sekuenca 2-3-5-9-17-33-.....?

- A) 56 B) 66 C) 65 D) 67

28) Ku ndodhen mbetjet e Babilonisë?

- A) Irak B) Afganistan C) Pakistan D) Iran

29) Cili nga turnetë e mëposhtëm të tenisit luhet në fushë me tapet bari?

- A) Wimbledon B) Australian Open C) U.S. Open D) Roland-Garros

30) Cila nga speciet e mëposhtme i përket kategorisë së gjitarëve?

- A) Oktapodi B) Peshkaqeni C) Krokodili D) Delfini


31) Fortësia e majës së lapsit 4B, klasifikohet si:

- A) E butë ? B) E fortë? C) Shumë e butë ? D) Mesatare ?

32) Sipas ligjit Osman, një formë e veçantë e pronësie e quajtur *Vakëf*, ishte toka në pronësi të:

- A) Funkionarëve të administratës B) Feudalëve ushtarak
C) Sulltanit D) Institucioneve fetare myslimane

33) Për të ekuilibruar sistemin e figurës duhet të bëjmë një spostim të njërit gur.




A) Asnjë nga alternativat (aksi është në ekuilibër).

B) Nga pozicioni 12 te pozicioni 9

C) Nga pozicioni 3 te pozicioni 4.

D) Nga pozicioni 3 te pozicioni 5.

34) Gjej alternativën që kompletton figurën?



35) Kush NUK ka qenë ndër firmëtarët e deklaratës së pavarësisë në 28 Nëntor 1912?

- A) Luigj Gurakuqi B) Mid'hat Frashëri C) Lef Nosi D) Isa Boletini

36) Kur u bë shpallja e pavarësisë së Kosovës?

- A) 17 janar 2008 B) 17 janar 2007 C) 17 shkurt 2008 D) 17 shkurt 2007

37) Si emërtohen, te ne, ndërtimet e varreve monumentale të njerëzve të shquar fetarë apo laik?

- A) Fyrbë B) Tarbë C) Hurb D) Tyrbe

38) Kur u bë Shqipëria anëtare me të drejta të plota në NATO?

- A) Prill 2009 B) Maj 2007 C) Shkurt 2008 D) Mars 2006

39) Doktor Gjilpëra është një vepër satirike me autor:

- A) Faik Konicën B) Andon Zako Çajupin
C) Lasgush Poradecin D) Mitrush Kutelin

40) Ali Pashë Tepelena duke pushtuar Janinën, i jep formë Pashallëkut të Janinës në vitin:

- A) 1822 B) 1797 C) 1787 D) 1812

41) Në vitin 1948, Shqipëria i ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me:

- A) Bashkimin Sovjetik B) Greqinë
C) Kinën D) Jugosllavinë

42) Tre miq ndajnë mes tyre një shumë prej 600 Eurosh në proporcion me numrat 5, 3, 2. Sa është shuma e atij që është më fatlumi mes të treve?


- A) 120 Euro B) 180 Euro C) 300 Euro D) 480 Euro

43) Cili nga trupat e paraqitur në pamje, korespondon me trupin që hedh hije në plan?




A)

B)




C)



D)

44) Në figurën e mëposhtme drejtkëndëshi EBCD është brendashkruar një rrethi me rreze r , ka bazën CD sa dyfishi i brinjës $BC = a$ dhe trekëndëshi ABE është dybrinjëshëm. Sa është sipërfaqja e poligonit ABCDE?




A) $3a^2 + 2ar$ B) $\frac{1}{2}a(3a+2r)$ C) $\frac{1}{2}a(3r+2a)$ D) $\frac{1}{2}a(3a-2r)$

45) Dyqani i firmës “Produkte bukurie”, ka një logo të re. Logoja do të vendoset në xham dhe nga jashtë dyqanit, duhet të duket si më poshtë.



Për fat të keq logon e ngjisin të rrotulluar me 180 gradë në sensin orar. Cila nga imazhet e mëposhtme është logoja e parë nga brenda dyqanit?




46) Në mitologjinë greke, hyjnesha e hënës, shtazëve të egra dhe gjuetisë ishte:

- A) Demetra B) Afrodita C) Artemida D) Hera

47) Lufta e Parë ballkanike filloi më:

- A) 6 shtator 1912 B) 28 dhjetor 1912 C) 26 nëntor 1912 D) 8 tetor 1912

48) Drejtkëndëshi i treguar në figurë ka sipërfaqen 28 m^2 dhe brinjët parallel me boshtet kartezianë. Llogarisni a , b , c , d dhe e .







- A) $a=2$, $b=9$, $c=6$, $d=9$, $e=3$ B) $a=3$, $b=10$, $c=6$, $d=10$, $e=2$
C) $a=3$, $b=9$, $c=6$, $d=6$, $e=9$ D) $a=3$, $b=10$, $c=6$, $d=10$, $e=3$

49) Kur e fitoi çmimin Nobel për Paqe Nënë Tereza?

- A) 1979 B) 1989 C) 1984 D) 1974

50) Lidhni boshtet me paraqitjen aksonometrike përkatëse, të kubit.



A) 1B, 2A, 3C, 4D

B) 1D, 2B, 3A, 4C

C) 2A, 3B, 4C, 1D

D) 3C, 1A, 2D, 4B

51) Ajasofia [Hagia Sophia] u ndërtua fillimisht si:

A) Tempull romak B) Pallat mbretëror C) Kishë D) Xhami

52) Tani dhe Nina janë dy fëmijë të vegjël. Tani gënjen të hënë, të martë, të mërkurë e thotë të vertetën ditët e tjera të javës. Nina gënjen të enjten, të premten dhe të shtunën, por thotë të vërtetën të gjitha ditët e tjera të javës. Një ditë X, Tani pohon: "Dje ishte një nga ato ditët që Nina tha të vërtetën."


Cila ditë e javës është dita X?

A) E Enjte B) E Diele C) E Mërkurë D) E Hënë

53) Një dysheme është e përbërë nga 64 pllaka të vogla të bardha të barabarta mes tyre. Nëse ngjyrosim me të kuqe të gjithë pllakat në bordurat e dyshemesë, sa pllaka të bardha do na ngelen?

A) 16 B) 21 C) 36 D) 25

54) Maria po mobilon kuzhinën e do ta bëjë me pjesë të gatshme për ta mbluluar gjithë faqen e murit dhe të ketë të paktën 2 sirtare. Faqja e kuzhinës është 3 metra e gjatë e Maria do ta shfrytëzojë të gjithën. Në katalogun e kuzhinës janë këto copë si më poshtë. Cili është kombinimi më ekonomik e i favorshëm për Marian?



A) 590 Euro B) 540 Euro C) 610 Euro D) 580 Euro

55) Në figurë paraqitet trupi në aksonometri. Cila nga alternativat e dhëna, paraqet tre projeksionet e tij?




- A) 4, 2, 5.
- B) 1, 4, 5.
- C) 5, 2, 1.
- D) 3, 4, 5.

56) Një pronar në një argjendari , me rastin e festës së gruas do t'u dhurojë 100 punonjësve të tij vathë për ato që i kanë veshët e shpuara. Duke qenë se 10 % kanë të shpuar vetëm njërin vesh, e pjesa tjetër e mbetur janë përgjysëm me veshë të shpuar ose jo, sa vathë duhet të dhurojë argjendari?

A) 200 B) 90 C) 100 D) 180

57) Në figurë paraqitet trupi në aksonometri, në qendër të kubit. Cila nga pamjet e dhëna, mund të shihet nga pika e shikimit S?



A)



B)





C)




D)


58) Në figurë paraqitet trupi në aksonometri. Cila nga pamjet e dhëna, paraqet projeksionin në anësor të tij?




A)



B)



C)




D)

59) Në hollin e një hoteli është varur në tavan një kub si zar loje që rrotullohet në sensin antiorar. (duke e parë nga poshtë) rreth një aksi vertikal qëndror. Në cdo faqe të zarit pikat janë me relief. Zari është I rregullt (që do të thotë se shuma e pikave në faqet e kundërta është 7). Kur e shikon nga njëra anë figura e zarit është si më poshtë:



Cili është imazhi që shihet nga i njëjti drejtim mbasi zari është rrotulluar me gjysëm rrethi.



60) Jan Kukuzeli ka qenë:

- A) Gjuhëtar B) Arkitekt C) Muzikant D) Shkrimtar